



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 49 Datë 29.05.2025

**PËR MIRATIMIN E ANGAZHIMIT FINANCIAR TË BASHKISË KORÇË PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS 9-VJEÇARE
“SOTIR GURRA DHE NDËRTIM PALESTRE”, ME CIKËL FINANCIMI 2025-2026**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave dhe Infrastrukturës dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK, duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin 115/2024 datë 03.12.2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, udhëzimin plotësues nr. 2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, VKB nr. 176 datë 26.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 të Bashkisë Korçë”, urdhërin nr.12 datë 14.01.2025 “Për detajimin e shpenzimeve për investime për vitin 2025 të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë sipas programeve dhe produkteve”, i ndryshuar, si dhe në urdhërin nr. nr. 60 datë 7.02.2025 “Për shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve nga programet “arsimi bazë”, “arsimi i mesëm” dhe programi “për sportin”, pjesë e programit për infrastrukturën shkollore e sportive, për projektet me cikël financimi 2025-2026”, mbështetur në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë kontributin financiar të Bashkisë Korçë për financimin e projektit Rikonstruksioni shkollës 9-vjeçare “Sotir Gurra dhe ndërtim palestre”, me cikël financimi 2025-2026 sipas tabelës së mëposhtme:

/lekë

Nr.	Emërtimi i projekteve	Vlera e totale e projektit	Kontributi 20% Bashkia	Angazhimi 10% 2025	Angazhimi 10% 2026	Kontributi 80% MAS	Angazhimi 2025	Angazhimi 2026
1	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Sotir Gurra” dhe ndërtim palestre	111,315,702	22,263,140	11,131,570	11,131,570	89,052,562	16,000,000	73,052,562
2	Mbikqyrje e objektit “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Sotir Gurra” dhe ndërtim palestre			1,216,307				
3	Kolaudimi i punimeve për objektin Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Sotir Gurra” dhe ndërtim palestre			145,957				
	Total	111,315,702	22,263,140	12,493,834	11,131,570	89,052,562	16,000,000	73,052,562

2. -Angazhimi buxhetor i Bashkisë është 23,625,404 lekë, e cila ndahet për vitin 2025 në vlerën prej 12,493,834 lekë, do të përballohet nga fondi i planifikuar për objektin “Investime në shkollat e arsimit bazë parashkollor”, në programin arsimi bazë parashkollor AG122, me këtë strukturë buxhetore:

Programi AG122 Prod. P912AAA 00 09120 05 Art. 2310000 12,493,834 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Planifikimit të Territorit, dhe Menaxhimit të Kontratave dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK si dhe Drejtoria e Prokurimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratur me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Pro _____

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 28-05-2025

KRYETAR

Ana Verushi

